



Republika e Kosovës



Komuna e Vushtrrisë

Drejtoria për Arsim

10 Nr. 291/18

Datë: 13.04.2018

Bazuar në Nenin 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, nenin 5. Pika c, të Ligjit nr. 03/L – 068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ, Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.06/2015 për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm. Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtri, shpall këtë :

KONKURS

Për vendet e lira punës

- **SHFMU ” Andon Zako Çajupi”Vushtrri**
1 Mësimdhënës/e për lënden gjuhë gjermane me kohë të caktuar.
1 Mësues/e klase me kohë të caktuar
- **SHFMU”Jusuf Gërvalla” Dumnice e Poshtme**
1 Mësues/e klase me kohë të caktuar
- **SHFMU”Nazmi Zhegrova” Stanoc i Poshtëm**
1 Mësues/e klase me kohë të pacaktuar.

Kushtet për mësimdhënës :

Për këto vende të punës kërkohet kualifikimi përkatës profesional, sipas Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.06/2015 Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të përgjithshëm.

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Gjuhë gjermane

- Fakulteti i Filologjisë-dega e Gjuhës dhe letërsisë gjermane.

Kriteret e kualifikimit për mësues/e klase.

- Fakulteti i Edukimit- programi fillor.
- Fakulteti i Mësuesisë.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim :

- Formulari i aplikimit i cili merret në zyrën e arkivit Komunal
- Diploma (Certifikata e diplomimit jo më e vjetër se gjashtë muaj) e fakultetit e fotokopjuar dhe e vërtetuar nga noteri
- Fotokopja e letërnjoftimit
- Vërtetimi i përvojës së punës
- Vërtetimi nga gjykata se nuk është nën hetime
- Certifikatat e trajnimeve.
- Të diplomuarit jashtë vendit diplomat e tyre duhet ti nënshtrohen procesit të nostrifikimit nga MASHT-i.

Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen. Konkursi mbetet i hapur 8 ditë prej ditës së shpalljes në shtyp, **prej datës 14.04.2018 deri me 23.04.2018.** Dokumentet e pakompletuara nuk shqyrtohen. Intervistimi me shkrim i kandidatëve mbahet më **24.04.2018, në ora: 13:30** në sallën e Kuvendit Komunal.